

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti Për Çështje Ekonomike**, me gjyqtaren Franciska Zhitia-Ymeri, duke vendosur në çështjen juridike të paditësit M.E.GmbH & C. KG, me seli në R., .. M-Gj, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit V.I avokat nga P, kundër të paditurës NTP “M” me seli në P, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit Sh.B avokat nga P, me objekt kontesti shkeljen e markës tregtare, në seancën e shqyrtimit e mbajtur më 13.11.2017 në prani të autorizuarit të palës paditëse dhe të autorizuarit të palës së paditur, ndërsa pas marrjes së fjalëve përfundimtare nga palët në procedure, ndërsa me datë 29.11.2017 merr këtë:

### **A K T G J Y K I M**

**I. REFUZOHET** kërkesëpadia e paditësit M.E.GmbH & Co.K, me seli në R. M-Gj, me të cilën ka kërkuar që të vërtetohet se e paditura NTP “M” me seli në P, përmes mallrave të tij, qese najlloni për mbeturina, me emrin “Strong” ka bërë shkelje të markës së mbrojtur tregtare “S”, ti ndalohet të paditurit shkelja e mëtutjeshme e të drejtave të markës tregtare të paditësit ashtu që i njëjti të urdhërohet që mallrat-qese najlloni për mbeturina me shkelje të markës tregtare të paditësit ti largojë nga tregu dhe të bëjë shkatërrimin e tyre me shpenzime të veta në afat prej 7 ditësh si dhe ti paguajë shpenzimet e procedurës kontestimore, në afatin kohor prej 7 (shtatë) ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

**II. KONSTATOHET** se paditësi M.E G& Co. KG, me seli në R. M-Gj, në këtë çështje juridike, **e ka tërheqë kërkesëpadinë për pikën e dytë** të precizimit të kërkesëpadiës së bërë me datë 13.07.2017, lidhur me kompensimin e dëmit si pasojë e shkeljes së markës tregtare, kundër të paditurit NTP “M” me seli në P.

**III. REFUZOHET** propozimi i të autorizuarit të palës së paditur NTP “M” me seli në P, lidhur me caktimin e masës së sigurisë për deponimin e të hollave lidhur me shpenzimet procedurale në shumë prej 2,500.00 euro, ndaj paditësit M.E. G& Co. KG, me seli në R. M-Gj.

**IV. DETYROHET** paditësi M.E G.& Co. KG, me seli në R. M-Gj, që palës së paditur t’ia paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë të përgjithshme prej 1,164.80 euro, në afatin kohor prej 7 (shtatë) ditëve pas pranimin të këtij aktgjykimi

### **A r s y e t i m**

Paditësi M.E G& Co. KG, me seli në R. M-Gj, ka parashtruar pranë kësaj gjykate padi me datë 13.04.2016, kundër të paditurit NTP “M” me seli në P, duke i propozuar kësaj gjykate qe ta aprovoj kërkesëpadinë e paditësit me të cilën do të vërtetohet se i padituri NTP “M” me seli në P, ka shkelur markën tregtare të paditësit përmes mallrave të tij, qese najlloni për mbeturina, me emrin strong ka bërë shkelje të markës së mbrojtur tregtare S, ashtu që ti ndalohet të paditurit shkelja e mëtutjeshme e të drejtave të markës tregtare të paditësit ashtu që i njëjti të urdhërohet që mallrat-qese najlloni për mbeturina me shkelje të markës tregtare

të paditësit ti largojë nga tregu dhe të bëjë shkatërrimin e tyre me shpenzime të veta në afat prej 7 ditësh, njëherit i ka kërkuar edhe shpenzimet e procedurës kontestimore.

I autorizuari i paditësit gjatë gjithë shqyrtimit të çështjes gjyqësore ka mbetur pranë padisë dhe kërkesës së tij, duke shtuar se paditësi është pronar i markës tregtare të regjistruar pranë zyres për pronësi industriale në Kosovë dhe marka tregtare S. është e mbrojtur në regjistrin e markave tregtare me vendimin nr. 6847/2012 të datës 13.03.2012. Produkti S. është regjistruar për shërbimin e klasës së 9, qese për pluhur për aspirator, ndërsa ngjyrat e mbrojtura janë: e kaltërt dhe e bardha. Duke shtuar se e paditura ka filluar me paketimin dhe shitjen e produktit qese najlloni Strong, i cili paketim është pothuajse identik me paketimin e produktit të paditësit, andaj dhe kjo paraqet shkelje të markës tregtare dhe për shkak të ngjajshmërisë ekziston mundësia e konfuzionit të konsumatorit ku përfshihet edhe mundësia e asociimit me markën e mëparshme dhe i ka kërkuar gjykatës që kërkesëpadia e paditësit të aprovohet në tërësi si e bazuar.

Shpenzimet e procedurës kontestimore i ka kërkuar dhe specifikuar.

I autorizuari i të paditurës përmes përgjigjes në padi dhe gjatë gjithë shqyrtimit gjyqësor ka kundërshtuar kërkesëpadinë e paditësit duke theksuar se e paditura nuk ka bërë kopjimin apo shkeljen e markës tregtare të paditësit, pasi që ai është pronar i markës tregtare të vetë origjinale dhe e njëta nuk e shkel markën tregtare të paditësit, po ashtu ka theksuar se paketimi i produktit të paditësit dallon nga paketimi i produktit të të paditurës ngase elementet dalluese e markës tregtare të paditësit shihet në ngjyra dhe për më tepër ka theksuar se produkte të paditësit shiten jashtë tregut të Kosovës andaj edhe nuk ekziston mundësia që konsumatorët të vëhen në konfuzion apo ngjajshmëri lidhur me produktin e të paditurës, andaj dhe i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadia e paditësit të refuzohet si e pa bazuar.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe specifikuar.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë të gjendjes faktike lidhur me çështjen konkrete juridike, gjykata ka administruar këto prova duke lexuar: vendimi me nr. 6847/2012 e datës 13.03.2012, vendimi me nr. 6924-1/2012 i datës 20.03.2012, bëhet shiqimi i fotodokumentacionit të mostrave të të dyja palëve në procedurë me 7 shtojca, kërkesa e datës 25.06.2015, përgjigje në kërkesë me datë 08.07.2015, shkresë e datës 26.08.2015, zotim për veprim, pa datë, përgjigje në otimin për veprim e datës 10.09.2015, shkresë nga Agjencioni i Pronësisë Industriale i datës 07.07.2015, aplikacioni i paditësit drejtuar Zyrës Industriale i datës 17.10.2008, vendimi me nr. 6924/2012, i datës 19.03.2012.

Gjykata me rastin e vendosjes lidhur me çmuarjen e të gjitha provave të administruara dhe prezantuara nga palët ndërgjyqëse, gjykata i vlerësoi të gjitha veç e veç dhe në varësi me njëra tjetrën në vështrim të nenit 8 paragrafi 1 dhe paragrafi 2 të Ligjit për Procedurën Kontestimore të Kosovës dhe gjeti se:

Nga vendimi me nr. 6847/2012 me datë 13.03.2012, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi e ka të mbrojtur markën tregtare me emërim S. me ngjyra të kaltër dhe të bardhë, e cila nuk ka qenë kontestuese as në mes palëve në procedurë.

Nga shkresa e dates 25.06.2015, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi ka njoftuar të paditurën lidhur me kërkesën për ndërprerjen e shkeljës së markës tregtare.

Nga përgjigjja e dates 08.07.2015, e të paditurës bërë në shkresën e paditësit të datës 25.06.2015, gjykata ka vërtetuar faktin se e paditura i ka ofruar mundësi paditësit për bashkëpunim dhe se e paditura ka filluar prodhimin me brendin Strong për mos e humbur tregun në Kosovë pasi që paditësi nuk ka distribuar më mallin e tij në Kosovë.

Kështu gjykata pas administrimit të provave të cekura pas vlerësimit dhe analizimit të të gjitha pretendimeve të palëve në procedurë të cekura në procesverbal edhe parashtresa gjykata ka ardhur në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është e pa bazuar për këto arsye:

Nga vështirmi me kujdes i të dy paketimeve të kontestuara gjykata ka gjetë se këto dy paketime janë të dallueshme dhe nuk përngjajnë njëra me tjetrën edhe pse kanë përafërsisht ngjyrë të njëjtë. Janë shenja të tjera që dallohen esencialisht siç janë: emri personal i markës, skicimi i markës, shkronjat e paketimit si dhe nën emrin Strong janë mbi shkrimet “Thasë për mbeturina” në katër gjuhë të ndryshme kurse tek marka S. është një mbi shkrim tjetër e që në mënyrë të qartë e bëjnë dallimin mes tyre.

Kështu paketimi i paditësit ka shkronja të tjera identifikuese siç janë: “S.”, e që këtë emërtim nuk e ka paketimi i të paditurit. Pastaj emërtimi nën emrin “S.” është fjala “O.M” në gjuhen gjermane që është fjala e parë me shkronja boll kurse fjala e dytë me shkronja të shtypura të një stili tjetër të vendosura në pjesën mbështjellëse të paketimit. Pastaj paketimi i paditësit në anën e djathtë të paketimit i ka dy gjethe ngjyrë të gjelbër ku mbi njëren gjethe është një insekt i kuq i vendosur të cilën nuk e kanë paketimet e të paditurës “Strong”, po ashtu paketimi i paditësit në anën e majtë ka një pjesë si shirit me ngjyrë të gjelbër me figura mbi të, kurse paketimi i të paditurës nuk e ka fare do të thotë se e ka vetëm ngjyrën e verdhë të qelët me mbi shkrimet Strong dhe thasë për mbeturina në katër gjuhë me një vizatim në anën e majtë të një thesi ngjyrë të bardhë, kurse paditësi e ka thesin në anën e majtë dhe me ngjyrë të gjelbër, që do të thotë që dallon nga gjyra e të paditurit.

Në rastin konkret produkti i paditësit dhe ai i të paditurës të vetmen ngjajshmëri ndërmjet tyre e kanë ngjyrën bazë dhe atë të verdhë e cila gjendet në dy produktet, ndërsa të gjitha elementet tjera i kanë të ndryshe, mënyra e dizajnit të ambalazhit dallon dukshëm sepse produkti i të paditurës përmbanë përshkrime tjera siç u cekën më lartë, që nuk kanë ngjajshmëri me produktin e paditësit.

Sipas nenit 5 të Ligjit për markat Tregtare, kusht për regjistrimin e markës tregtare është mundësia e paraqitjes grafike të markës, ndërsa me vendimin e MTI-së, marka tregtare e paditësit “S.” është regjistruar si kombinim i ngjyrave të mbrojtura kaltër e bardhë në dizajnin e caktuar dhe se kjo markë tregtare gëzon mbrojtje vetëm me këtë dizajn të dhënë në vendim, sepse do të ishte jashtë çdo logjike që paditësi me vetë faktin e regjistrimit dhe mbrojtjes së ngjyrave të caktuara t’i mohojë çdo prodhuesi përdorimin e këtyre ngjyrave në çfarëdo forme dhe në çfarëdo kombinimi. Prandaj gjykata ka vlerësuar se përdorimi i ngjyrave përafërsisht të njëjta me nuanca dalluese në produktin e të paditurës, në dizajn, formë tjetër dhe me kombinime tjera nuk e shkelin markën tregtare të paditësit.

Gjykata ka gjetur se ekzistojnë dallime të dukshme edhe në elementin “aural” sepse shenja “S.” dhe “Strong” kanë dallime të theksuara në shprehjen e tyre, mandje ato janë plotësisht të ndryshme, andaj edhe në këtë element produkti i të paditurës nuk mund të shkaktojë konfuzion te konsumatori.

Po ashtu gjykata ka vlerësuar edhe formën e paketimit të produkteve përkatësisht formën cilindrike të ambalazhit e cila është e njëjt tek të dy produktet dhe se në këtë rast forma përbën “një formë funksionale” të vetë produktit siç parashihet edhe në nenin 6 pik 1.5 të Ligjit për Markat Tregtare i cili e ndalon mbrojtjen e shenjave të cilat përbejnë një trajtë që 1) rezulton nga natyra e vetë mallit përkatës, 2) është e nevojshme për të arritur një rezultat teknik ose 3) i jep vlerë thelbësore mallit në fjalë, andaj sipas kësaj dispozite një formë që është funksionale nuk mund të gëzojë mbrojtje. Nocioni i funksionalitetit është mekanizëm për parandalimin e monopolit mbi një formë të caktuar të mallit e cila është e nevojshme për arritjen e një rezultati të caktuar. Forma e paketimit të produkteve kontestuese përdoret te të gjitha produktet e kësaj natyre, prandaj përdorimi i kësaj forme nuk mund të ndalohe, përkatësisht përdorimi i kësaj forme nuk përbën shkelje të markës tregtare.

Po ashtu edhe në paketimet tjera të paditurës ekzistojnë dallime esenciale të produkteve të cilat në mënyrë shumë të qartë dallojnë në mes veti dhe atë produkti tjetër i paditësit “S.” është me ngjyrë të verdhë duke anuar nga ngjyra e portokalltë dallon nga produkti i të paditurës Strong pasi që i njëjti ka ngjyrë të verdhë në anën e majtë ka një thesë ngjyrë të zezë me mbi shkrimin “i qëndrueshëm” dhe gjysma e shiriti është ngjyrë e kaltër me një vijë ngjyrë të gjelbërt që ndan ngjyrën e verdhë nga ngjyra e kaltër, po ashtu në formë të pjerrët në mes të ambalazhit ka një shirit ngjyrë të kaltër të cilin nuk e ka produkti i paditësit, karakteristika këto që i bëjnë dallueshme produktet në mes veti, andaj të gjitha këto e bëjnë që të mos të përmbushen kushtet e parapara në nenin 6 dhe 7 të Ligjit mbi Markën Tregtare, sepse nuk ekziston mundësi e mashtrimit të konsumatorit sa i përket shenjave dalluese të këtyre paketimeve, andaj edhe gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

I autorizuari i palës paditëse në seancën e datës 13.11.2017, e ka tërheqë kërkesëpadinë për pikën e dytë të precizimit të kërkesëpadisë së bërë me parashtresën e datës 13.07.2017, lidhur me kompensimin e dëmit si pasojë e shkeljes së markës tregtare kundër të paditurit, andaj gjykata ka vendosur si në pikën II, të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

I autorizuari i palës së paditurë në seancën e datës 13.11.2017, gjykatës i ka dorëzuar me shkrimin propozimin për caktimin e masës së sigurisë për deponimin e të hollave për shpenzimet e procedurës kontestimore.

Gjykata me rastin e refuzimit të propozimit të autorizuarit të palës së paditur lidhur me caktimin e masës së sigurisë për deponimin e shumës prej 2,500.00 euro, në emër të shpenzimeve kontestimore në rast të humbjes së kontestit, e në të kundërtën ato mjete do ti kthehen paditësit pas plotëfuqishmerisë së aktgjykimit, është bazuar konkretisht në dispozitën e nenit 297 paragrafi 1 pika a dhe pika b, të LPK-së, e cila parasheh se “*Masa e sigurimit mund të caktohet: a) në qoftë se propozuesi i sigurimit e bënë të besueshme ekzistimin e kërkesës apo të së drejtës subjektive të tij*” dhe b) “*në qoftë se ekziston rreziku se pa caktimin e masës së këtyre palës kundërshtarë do të mund ta pamundësonte apo vështirësonte dukshëm realizimin e kërkesës, sidomos me tjetërsimin e pasurisë së vet, me fshehjen e saj, me*

*ngarkimin apo me ndonjë mënyrë tjetër, me të cilën do ta ndryshonte gjendjen ekzistuese të gjërave, ose në ndonjë mënyrë tjetër do të ndikonte negativisht në të drejtat e propozuesit të sigurimit”.*

Bazuar në dispozitat e lartë cituara për caktimin e masës së sigurimit duhet të plotësohen në mënyrë kumulative kushtet ligjore sipas të cilave propozuesi duhet ta bëjë të besueshme ekzistimin e kërkesës dhe rrezikun se pa caktimin e masës së këtillë pala kundërshtarë do të mund ta pamundësonte apo vështirësonte dukshëm realizimin e kërkesës së propozuesit e që në rastin konkret asnjëri nga kushtet ligjore nuk janë plotësuar, andaj edhe gjykata ka vendos që ta refuzoj këtë masë për arsye të cekura më lartë dhe ka vendosur si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës kontestimore është marrë në bazë të nenit 452. paragrafi 1 të LPK-së, në rastin konkret shpenzimet e krijuara gjyqësore si detyrim i paditësit i referohen shumës së precizuar si në pikën IV të dispozitivit të këtij aktgjykimit, e cila përfshin shpenzimet procedurale të kërkuara dhe të provuara nga i padituri dhe atë: për përgjigjen në padi shumën prej 208.00 euro, për përpilimin e dy parashtresave nga 208.00 euro (2x208) shumën prej 416.00 euro, si dhe në emër të përfaqësimit në dy seanca gjyqësore (2x270.40 euro) shumën prej 540.80 euro, gjithsej shumën prej 1,164.80 euro.

Andaj nga të cekurat si më lart dhe duke u bazuar në nenin 5, 6, 7 të Ligjit për Markat Tregtare si dhe në nenin 143 paragrafi 1, në nenin 297 paragrafi 1 pika a dhe pika b, të LPK-së, Gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**  
**Departamenti Për Çështje Ekonomike**  
**III.EK.nr.209/16 me datë 29.11.2017**

**Gjyqtarja**  
Franciska Zhitia-Ymeri

**KËSHILLË JURIDIKE:** Ndaj këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afatin kohor prej 7 (shtatë) ditëve, nga dita e marrjes së tij, duke iu drejtuar Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.